

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MIN.E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **203-26-5241-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me mekanizem bujqesor (traktor)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K.
NUI	810396772
Adresa	Xhelal Hajda - Toni
Vendi	Rahovec
Kodi postar	162
Numri Telefonit	+38345111307
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Shkumbin Haxhijaha
Adresa elektronike	info@haxhijaha.com
Data e parashtrimit të ankesës	27.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me mekanizem bujqesor (traktor)

1. Njoftim per Kontrat – 09.07.2026
2. Kërkesa per sqarim – 15.07.2026
3. Pergjigje ne kerkes per sqarim – 17.07.2026
4. Kërkes per rishqyrtim – 21.07.2026
5. Vendimi ne kerkes per rishqyrtim: 23.07.2026
6. Ankesa ne OSHP: 27.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Nuk pajtohem me vendim e AK-se

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Sipas Nenit 108/A të ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ankesa mund të dorëzohet, pa pagesë, nga cilado palë e interesuar në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje në ligjin aktual, apo akteve të nxjerra në zbatim të tij.

Ne konsiderojmë që AK ka shkelur dispozitat ligjore në keto Nene:

Neni 1: Qëllimi

Neni 6: Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 27: Dosja e Tenderit

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 53: Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne nuk pajtohemi me pretendimet e Autoritetit Kontraktues (AK) të paraqitura në vendimin e tyre lidhur me kërkesën tonë për rishqyrtim. Konsiderojmë se konstatimet dhe arsyetimet e dhëna nga AK nuk qëndrojnë dhe nuk janë në përputhje me faktet dhe provat e paraqitura nga ana jonë. Për të gjitha pretendimet e ngritura në kërkesën tonë për rishqyrtim, ne kemi ofruar fakte, dëshmi dhe argumente konkrete të cilat vërtetojnë shkeljet dhe parregullsitë e pretenduara. Këto prova janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar, mirëpo AK nuk i ka trajtuar ato në mënyrë të plotë dhe objektive gjatë marrjes së vendimit të kontestuar. Andaj, ne mbetemi pranë të gjitha pretendimeve tona të paraqitura më herët dhe do t'i argumentojmë ato para OSHP-së përmes fakteve dhe dokumenteve përkatëse, duke kërkuar që të shqyrtohen me kujdes të gjitha rrethanat e rastit dhe të merret një vendim në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

1. Kapaciteti i rezervuarit të karburantit – 130 litra

Në kërkesën tonë për sqarime të datës 15.07.2026, kemi njoftuar Autoritetin Kontraktues se, bazuar në hulumtimet e kryera në tregun e Kosovës, tregun rajonal dhe atë ndërkombëtar, kemi konstatuar se traktori me karakteristika teknike të ngjashme me ato të kërkuara në dosjen e tenderit nuk ofrohet me rezervuar karburanti prej **130 litrave**, por me kapacitet **129 litra**.

Në përgjigjen e datës 17.07.2026, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë sqarim lidhur me këtë konstatim dhe nuk ka kontestuar faktin se në treg ekziston një kapacitet prej 129 litrave. Përkundrazi, ai është arsyetuar se kërkesa për rezervuar prej 130 litrash është përcaktuar mbi bazën e **nevojave operative** dhe kohëzgjatjes së punës së traktorit, duke theksuar se nuk i referohet ndonjë modeli të caktuar.

Kjo përgjigje nuk përbën sqarim të kërkesës sonë, por një arsyetim të specifikimit teknik. Për më tepër, vetë përgjigja e Autoritetit Kontraktues konfirmon se specifikimi nuk është hartuar duke iu referuar standardeve teknike të parapara me Ligjin për Prokurimin Publik, por mbi bazën e një vlerësimi të brendshëm të "nevojave operative".

Ky veprim është në kundërshtim me nenin 28, paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton se:

"Autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian, (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim."

Nga vetë deklarimi i Autoritetit Kontraktues rezulton se specifikimi për rezervuarin prej 130 litrash nuk është mbështetur në ndonjërin nga standardet e përcaktuara në nenin 28 të LPP-së, por është formuluar vetëm mbi bazën e "nevojave operative". Një qasje e tillë nuk është në përputhje me kërkesat ligjore për hartimin e specifikimeve teknike.

Për më tepër, dallimi ndërmjet një rezervuari prej **129 litrash** dhe një rezervuari prej **130 litrash** është vetëm **1 litër**, dallim i cili nuk paraqet ndonjë ndryshim real ose substancial në performancën, funksionalitetin apo kohëzgjatjen e punës së traktorit. Prandaj, insistimi në një kapacitet fiks prej 130 litrash nuk është proporcional me nevojën e pretenduar nga Autoriteti Kontraktues dhe kufizon pa arsye konkurrencën.

Për këto arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta ndryshojë këtë specifikim teknik duke: Formuluar specifikimin teknik në përputhje me nenin 28, paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke iu referuar standardeve teknike përkatëse dhe jo vetëm "nevojave operative"

Përgjigje ne Vendimin e AK-se, pika 1:

Në përgjigjen e Autoritetit Kontraktues (AK) ndaj këtij pretendimi tonë, ky pretendim është cilësuar si i pabazuar me arsyetimin se ne nuk kemi ofruar fakte dhe prova konkrete. Megjithatë, nga shqyrtimi i pretendimit tonë të paraqitur më lart, rezulton qartë se ne jo vetëm që kemi paraqitur fakte dhe argumente konkrete, por gjithashtu kemi sqaruar se janë pikërisht kërkesat e përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues në specifikat teknike ato që nuk janë hartuar në përputhje me standardet e zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe standardet evropiane, të cilat janë të përcaktuara në nenin 28, paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Në veçanti, ne kemi argumentuar se kërkesa teknike për kapacitetin prej 1 litër më shumë nuk paraqet ndonjë dallim të rëndësishëm në aspektin e funksionalitetit dhe operimit të traktorit, mirëpo një kërkesë e tillë kufizuese krijon pengesa të panevojshme për operatorët ekonomikë potencialë dhe zvogëlon mundësinë e një pjesëmarrjeje sa më të gjerë në këtë aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu, qëndrimi i AK-së i shprehur fillimisht në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për sqarim, e më pas edhe në vendimin lidhur me kërkesën për rishqyrtim, në fakt e përforcon pretendimin tonë se Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar kërkesat teknike bazuar në ndonjërin prej standardeve të përcaktuara në nenin 28 të LPP-së, por është mbështetur vetëm në pretendimin për nevoja operative.

Një qasje e tillë nga ana e AK-së rezulton në kufizimin e qasjes së operatorëve ekonomikë të interesuar dhe cenon parimin e konkurrencës së drejtë dhe gjithëpërfshirëse në procedurat e prokurimit publik. Për këtë arsye, ne mbetemi pranë pretendimit tonë se specifikat teknike të përcaktuara nga AK nuk janë të justifikuara në mënyrë objektive dhe proporcionale, por krijojnë kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë aktivitet të prokurimit.

2. Dalje hidraulike të mesme – minimum 2 dalje

Në kërkesën tonë për sqarime të datës 15.07.2026 kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues të sqarojë se çfarë nënkupton me termin "**minimum 2 dalje hidraulike të mesme**", pasi ky term nuk është i qartë dhe nuk përdoret në specifikimet standarde teknike të prodhuesve të traktorëve bujqësorë.

Në përgjigjen e datës 17.07.2026, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë sqarim lidhur me kuptimin e këtij termi. Në vend të kësaj, ai ka shpjeguar qëllimin për të cilin, sipas tij, nevojiten këto dalje hidraulike. Një përgjigje e tillë nuk i përgjigjet pyetjes së parashtruar dhe nuk sqaron termin teknik të përdorur në dosjen e tenderit, por përmban vetëm arsyetime që i ngjajnë një përgjigjeje ndaj kërkesës për rishqyrtim.

Nga hulumtimet tona në tregun vendor, rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe bazuar në katalogët teknikë dhe dokumentacionin e prodhuesve të traktorëve bujqësorë, kemi konstatuar se prodhuesit standardisht ofrojnë **dalje hidraulike të përparme** dhe **dalje hidraulike të pasme**, ndërsa nuk përdorin termin "**dalje hidraulike të mesme**". Për ne, si operator ekonomik me përvojë shumëvjeçare në furnizimin me mekanizëm bujqësor, ky

është një term i panjohur dhe i papërdorur nga prodhuesit.

Po ashtu, traktorët me fuqi motori të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues zakonisht pajisen me **minimum pesë (5) dalje hidraulike të pasme**, të cilat janë plotësisht të mjaftueshme dhe funksionale për përdorimin e pajisjeve bujqësore të destinuara për këtë kategori traktori.

Në praktikë, "daljet hidraulike të mesme" nuk janë pjesë e konfigurimit standard të prodhuesit, por mund të realizohen vetëm përmes ndërhyrjeve ose modifikimeve të mëvonshme nga operatorë ekonomikë ose servise të autorizuar. Një zgjidhje e tillë përbën improvizim teknik dhe jo pajisje standarde të prodhuesit. Për më tepër, vendosja e daljeve hidraulike në pjesën e mesme të shasisë mund të krijojë pengesa gjatë operimit të traktorit, të kufizojë lëvizjen dhe të ndikojë negativisht në sigurinë dhe funksionalitetin e tij.

Nga përgjigjja e Autoritetit Kontraktues krijohet përshtypja se kërkesa është hartuar duke pasur parasysh një zgjidhje të improvizuar dhe jo një specifikim teknik të standardizuar nga prodhuesit. Edhe kjo bie në kundërshtim me nenin 28, paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik, i cili obligon autoritetet kontraktuese që specifikimet teknike t'i hartojnë duke iu referuar standardeve teknike të njohura dhe jo zgjidhjeve të improvizuara ose konfigurimeve që nuk mbështeten në standardet e prodhuesve.

Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

1. Të rishqyrtojë këtë specifikim teknik dhe ta formulojë atë në përputhje me nenin 28, paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik, duke iu referuar standardeve teknike të njohura të prodhuesve.
2. Të zëvendësojë kërkesën për "**minimum 2 dalje hidraulike të mesme**" me një kërkesë që i referohet konfigurimit standard të prodhuesve, siç janë daljet hidraulike të përparme ose të pasme, të dokumentuara edhe në certifikatën e konformitetit (COC) dhe dokumentacionin teknik të prodhuesit.
3. Të kërkojë, nëse e konsideron të nevojshme për nevojat operative, **minimum pesë (5) dalje hidraulike të pasme**, të cilat përbëjnë standardin për këtë kategori traktori dhe mundësojnë përdorimin normal të pajisjeve bujqësore pa pasur nevojë për modifikime ose improvizime.

Ndryshimi i këtij specifikimi do të siguronte respektimin e dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, do të eliminonte një kërkesë që nuk bazohet në standardet e prodhuesve dhe do të mundësonte konkurrencë më të gjerë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Përgjigje ne Vendimin e AK-se, pika 2:

Lidhur me këtë pretendim, ne kemi ofruar pranë Autoritetit Kontraktues (AK) të gjitha

faktet dhe argumentet konkrete që mbështesin pretendimet tona. Kemi sqaruar se daljet hidraulike standarde të traktorëve, sipas praktikave dhe specifikimeve të prodhuesve, janë të pozicionuara në pjesën e përparme dhe të pasme të traktorit, ndërsa terminologjia e përdorur nga AK-ja për “dalje të mesme” nuk përbën një standard të njohur nga prodhuesit e traktorëve, por paraqet një specifikim të veçantë i cili mund të jetë rezultat i një përpunimi ose modifikimi nga servise të caktuara.

Po ashtu, kemi argumentuar se traktorët me fuqinë motorike të kërkuar nga AK-ja posedojnë minimalisht pesë (5) dalje hidraulike të pasme, të cilat janë plotësisht të mjaftueshme për funksionalizimin e pajisjeve dhe makinerive të tjera që do të bashkëngjiten në traktor. Për këtë arsye, kërkesa shtesë për dalje hidraulike të ashtuquajtura “të mesme”, të cilat nuk janë pjesë e konfigurimit standard të prodhuesve të traktorëve, nuk është e arsyetuar në aspektin teknik dhe nuk mbështetet në ndonjë standard të zbatueshëm në Republikën e Kosovës apo në Evropë.

Insistimi i AK-së që traktori të posedojë modifikim të daljeve hidraulike, të cilat nuk janë të parashikuara nga prodhuesi i traktorit, përbën një kërkesë kufizuese dhe cenon parimet e transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Një kërkesë e tillë nuk është e bazuar në ndonjë standard teknik të aplikueshëm për prodhimin e traktorëve dhe nuk është dëshmuar nga AK-ja se është e domosdoshme për përmbushjen e qëllimit të prokurimit.

Gjithashtu, ne kemi kërkuar nga AK-ja të sqarojë arsyen teknike se për çfarë qëllimi do të përdoren këto dalje hidraulike të pretenduara si “të mesme”, duke marrë parasysh faktin se asnjë pajisje ose makineri që bashkëngjitet në traktor nuk montohet në pjesën e mesme të traktorit. Megjithatë, AK-ja nuk ka ofruar ndonjë arsyetim teknik dhe as ndonjë dëshmi konkrete që do ta justifikonte këtë kërkesë.

Për më tepër, AK-ja kërkon nga operatorët ekonomikë të interesuar të paraqesin fakte për të kundërshtuar një kërkesë të cilën vetë AK-ja nuk e ka arsyetuar dhe nuk e ka lidhur me ndonjë standard teknik të aplikueshëm. Përkundër fakteve të paraqitura nga ana jonë, AK-ja nuk ka pranuar as mundësinë që kërkesa të plotësohet përmes minimumit prej pesë (5) daljeve hidraulike të pasme, e cila është edhe kërkesë e vetë AK-së, duke e bërë këtë qëndrim të pajustificueshëm dhe të pashpjeguar nga aspekti teknik.

Bazuar në të gjitha këto rrethana, ne konsiderojmë se insistimi i AK-së për këtë specifikim të veçantë krijon dyshime të arsyeshme se kërkesa mund të jetë hartuar në favor të një operatori ekonomik të caktuar, i cili posedon traktor me modifikime specifike të daljeve hidraulike. Këto modifikime nuk janë të dëshmuara si standarde të prodhuesve të traktorëve dhe nuk mbështeten në ndonjë standard teknik të zbatueshëm në Republikën e Kosovës apo në Evropë.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se kjo kërkesë teknike është kufizuese, nuk është proporcionale me nevojat reale operative të AK-së dhe cenon mundësinë e pjesëmarrjes së gjerë të operatorëve ekonomikë në këtë procedurë të prokurimit.

3. Pasqyra teleskopike me kënd të gjerë

Ndryshe nga pikat e tjera të kërkesës sonë për sqarime, lidhur me këtë specifikim teknik Autoriteti Kontraktues ka dhënë një sqarim. Megjithatë, bazuar në përmbajtjen e kësaj përgjigjeje, konsiderojmë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme për të kërkuar rishqyrtimin e këtij kriteri.

Sipas vlerësimit tonë profesional dhe përvojës sonë shumëvjeçare në furnizimin me mekanizëm bujqësor, kërkesa që traktori të jetë i pajisur me **pasqyra teleskopike me kënd të gjerë** nuk është një kërkesë teknike e domosdoshme për realizimin e qëllimit të kontratës.

Traktorët e prodhuar sipas standardeve të prodhuesve pajisen me pasqyra standarde, të cilat sigurojnë shikueshmëri të mjaftueshme prapa dhe në anët e traktorit, duke garantuar funksionim të sigurt dhe përmbushjen e kërkesave të sigurisë në komunikacion dhe gjatë operimit të mekanizmit bujqësor.

Një kërkesë e tillë rrit në mënyrë të panevojshme koston e furnizimit, kufizon numrin e operatorëve ekonomikë që mund të ofrojnë traktorë në konfigurimin standard të prodhuesit dhe, si rrjedhojë, kufizon konkurrencën pa ndonjë përfitim real funksional për Autoritetin Kontraktues.

Në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë, specifikimet teknike duhet të kufizohen vetëm në ato karakteristika që janë objektivisht të domosdoshme për realizimin e kontratës dhe nuk duhet të përfshijnë kërkesa që rrisin artificialisht koston ose favorizojnë konfigurime të veçanta të produktit.

Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta rishqyrtojë këtë specifikim teknik dhe të lejojë ofertimin edhe të traktorëve të pajisur me **pasqyra standarde të prodhuesit**, të cilat sigurojnë shikueshmëri të mjaftueshme dhe përmbushin standardet e sigurisë. Një ndryshim i tillë do të rriste konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, do të siguronte trajtim të barabartë të tyre dhe do të mundësonte përdorim më efikas të fondeve publike, pa cenuar funksionalitetin ose sigurinë e traktorit.

Përgjigje ne Vendimin e AK-se, pika 3:

Edhe në këtë pikë, ne i kemi dëshmuar Autoritetit Kontraktues (AK) se lejimi i ofertimit me pasqyra standarde siguron qasje më të gjerë për operatorët ekonomikë të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit.

Gjithashtu, kemi theksuar se, sa i përket kërkesës së AK-së që pasqyrat të mundësojnë shikueshmërinë e pajisjeve të vendosura prapa tyre, pasqyrat standarde janë të mjaftueshme për përmbushjen e këtij funksioni gjatë operimit të traktorit. Kërkesa shtesë

që ato të jenë teleskopike paraqet një rritje të panevojshme të vlerës së traktorit, duke shkaktuar shpenzim joefikas të fondeve publike për një specifikacion teknik i cili, në praktikë, mbulohet edhe me pasqyrat standarde.

Për këtë arsye, konsiderojmë se kërkesa për pasqyra teleskopike nuk është proporcionale me nevojën operative dhe kufizon pa arsye konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

4. Ngarkuesi frontal me lugë ngarkuese – "6 operationale"

Në kërkesën tonë për sqarime të datës 15.07.2026 kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues të sqarojë se çfarë nënkupton me kërkesën që **ngarkuesi frontal me lugë ngarkuese të jetë "6 operationale"**, pasi ky term nuk është i qartë dhe nuk është shpjeguar në dokumentacionin e tenderit.

Në përgjigjen e datës 17.07.2026, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë një sqarim konkret mbi kuptimin e këtij termi. Në vend të kësaj, ka dhënë arsyetime lidhur me mënyrën e funksionimit të sistemit hidraulik të ngarkuesit frontal dhe ka shtuar kërkesa të reja që nuk janë pjesë e dokumentacionit të tenderit.

Konkretisht, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që ngarkuesi frontal dhe luga ngarkuese të jenë të montuara nga fabrika, si dhe ka kërkuar që operatorët ekonomikë në ofertat e tyre të paraqesin përshkrimin teknik të gjashtë operacioneve të ngarkuesit frontal. Asnjëra prej këtyre kërkesave nuk është përcaktuar në dosjen e tenderit dhe nuk përbën përgjigje ndaj pyetjes sonë.

Thelbi i kërkesës sonë ishte të sqarohej se **cilat janë gjashtë operacionet** që Autoriteti Kontraktues kërkon të realizohen nga ngarkuesi frontal. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar këto operacione dhe nuk ka dhënë asnjë përkufizim teknik të termit "6 operationale".

Në këto rrethana lind pyetja se si operatorët ekonomikë mund të dëshmojnë përmbushjen e një kërkesë, kur vetë Autoriteti Kontraktues nuk ka sqaruar se çfarë kërkon të dëshmohet. Kërkimi i përshkrimeve teknike për "gjashtë operacionet", pa përcaktuar paraprakisht se cilat janë ato operacione, krijon paqartësi, cenon sigurinë juridike të procedurës dhe lë hapësirë për vlerësim subjektiv gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Për më tepër, përmes përgjigjes ndaj kërkesës sonë për sqarime, Autoriteti Kontraktues ka shtuar kërkesa të reja që nuk kanë qenë pjesë e dokumentacionit fillestar të tenderit. Procedura e sqarimeve nuk mund të përdoret për të ndryshuar ose zgjeruar specifikimet teknike apo për të vendosur kritere të reja që operatorët ekonomikë nuk i kanë pasur në dispozicion në momentin e përgatitjes së ofertave.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur për qëllim që këto kërkesa shtesë të merren parasysh gjatë vlerësimit të ofertave, atëherë kjo do të cenonte parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe sigurisë juridike, pasi operatorët ekonomikë nuk mund të vlerësohen mbi

bazën e kërkesave që nuk janë pjesë e dokumentacionit të tenderit.

Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

1. Të rishqyrtojë këtë specifikim teknik dhe të sqarojë qartë se çfarë nënkupton me termin **"6 operacionale"**, duke përcaktuar në mënyrë të saktë operacionet që kërkohen.
2. Të largojë nga përgjigjja çdo kërkesë shtesë që nuk është pjesë e dokumentacionit të tenderit, përfshirë kërkesën për paraqitjen e përshkrimeve teknike të "gjashtë operacioneve" dhe çdo kërkesë tjetër të shtuar pas publikimit të dosjes së tenderit.
3. Të sigurojë që vlerësimi i ofertave të bëhet vetëm mbi bazën e kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë, të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik.

Vetëm një qasje e tillë siguron një procedurë të qartë, të parashikueshme dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, duke shmangur paqartësitë dhe vlerësimet subjektive gjatë shqyrtimit të ofertave.

Përgjigje ne Vendimin e AK-se, pika 4:

Në përgjigjen e tij ndaj këtij pretendimi, Autoriteti Kontraktues e ka cilësuar atë si të pabazuar, duke theksuar se nuk ka zgjeruar specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit. Megjithatë, ne nuk kemi pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar specifikimet teknike të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Pretendimi ynë ka qenë konkretisht se Autoriteti Kontraktues, përmes sqarimeve të dhëna, ka kërkuar që ngarkuesi frontal dhe luga ngarkuese të jenë të montuara nga fabrika, si dhe ka kërkuar që operatorët ekonomikë, në ofertat e tyre, të paraqesin përshkrimin teknik të gjashtë operacioneve të ngarkuesit frontal. Këto kërkesa nuk janë të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe nuk përbëjnë përgjigje ndaj çështjes së ngritur nga ana jonë.

Thelbi i kërkesës sonë ka qenë që Autoriteti Kontraktues të sqarojë se cilat janë saktësisht gjashtë operacionet që kërkohet të realizohen nga ngarkuesi frontal. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka identifikuar këto operacione dhe nuk ka ofruar ndonjë përkufizim apo specifikim teknik për termin "6 operacione".

Në këto rrethana, shtrohet pyetja se si operatorët ekonomikë mund të dëshmojnë përmbushjen e një kërkesë të caktuar, kur vetë Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar qartë se çfarë duhet të dëshmohet. Kërkimi i përshkrimeve teknike për "gjashtë operacionet", pa përcaktuar paraprakisht natyrën dhe përmbajtjen e këtyre operacioneve, krijon paqartësi në procedurën e prokurimit, cenon parimin e transparencës dhe sigurisë juridike, si dhe krijon mundësi për interpretim subjektiv gjatë procesit të vlerësimit të ofertave.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim që të japë një

sqarim të qartë dhe të matshëm lidhur me këtë kërkesë teknike, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë mundësi të barabarta për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave të tyre.

5. Mbajtësi i peshave përpara me tërheqëse

Në kërkesën tonë për sqarime të datës 15.07.2026 kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues të sqarojë se çfarë nënkupton me specifikimin teknik "**mbajtësi i peshave përpara me tërheqëse**", pasi ky specifikim nuk është i qartë dhe, sipas vlerësimit tonë profesional, nuk mund të realizohet njëkohësisht me konfigurimin tjetër të kërkuar në dosjen e tenderit.

Në kërkesën tonë kemi sqaruar se traktorët e pajisur me **ngarkues frontal (lugë frontale)** nuk mund të pajisen njëkohësisht edhe me mbajtës standard të peshave përpara, pasi të dy komponentët montohen në të njëjtën pjesë ballore të traktorit. Për këtë arsye, nga pikëpamja teknike nuk ekziston hapësira e nevojshme për instalimin e të dy pajisjeve në konfigurimin standard të prodhuesit.

Gjithashtu, kemi sqaruar se mbajtësi i peshave përpara përdoret për vendosjen e peshave balancuese, të cilat kanë funksion stabilizues kur në pjesën e pasme të traktorit përdoren pajisje bujqësore me peshë të konsiderueshme. Qëllimi i tyre është të shmangin ngritjen e pjesës së përparme të traktorit dhe të ruajnë stabilitetin gjatë punës.

Në rastin konkret, kur traktori është i pajisur me **ngarkues frontal**, vetë pesha dhe konstruksioni i ngarkuesit frontal kryejnë funksionin e balancimit të pjesës së përparme të traktorit. Për këtë arsye, kërkesa për mbajtës të peshave përpara bëhet teknikisht e panevojshme dhe nuk ka funksion praktik në konfigurimin e kërkuar.

Nga përgjigjja e Autoritetit Kontraktues konstatohet se edhe vetë ai nuk ka sqaruar në mënyrë të qartë përmbajtjen e këtij specifikimi. Në një pjesë të përgjigjes i referohet sistemit të tërheqjes, ndërsa në pjesën tjetër mbajtësit të peshave, duke trajtuar dy elemente teknike me funksione të ndryshme. Për rrjedhojë, përgjigjja nuk sqaron kërkesën e parashtruar, por krijon paqartësi shtesë lidhur me atë se çfarë kërkohet realisht nga operatorët ekonomikë.

Për më tepër, funksionet që Autoriteti Kontraktues i atribuohen mbajtësit të peshave dhe sistemit të tërheqjes realizohen tashmë nga konfigurimi me **ngarkues frontal**, i cili është kërkuar si pjesë e detyrueshme e specifikimeve teknike. Kjo tregon se kërkesa për mbajtës të peshave përpara nuk është e domosdoshme për realizimin e nevojave operative dhe nuk është në përputhje me konfigurimin teknik të traktorit të kërkuar.

Për këto arsye, konsiderojmë se kjo kërkesë:

- është teknikisht e parealizueshme në konfigurimin standard të prodhuesve;
- është e panevojshme, pasi funksioni i saj realizohet nga ngarkuesi frontal;
- krijon paqartësi për operatorët ekonomikë dhe vështirësi gjatë përgatitjes së ofertave; dhe
- kufizon konkurrencën duke kërkuar një konfigurim që nuk është standard dhe që nuk mund të ofrohet nga shumica e prodhuesve.

Prandaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta rishqyrtojë këtë specifikim teknik, ta largojë kërkesën për **mbajtës të peshave përpara me tërheqëse**, ose ta reformulojë atë në përputhje me konfigurimet standarde të prodhuesve dhe me nevojat reale të kontratës, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, siç kërkohet nga Ligji për Prokurimin Publik.

Së fundi, duke pasur parasysh se Autoriteti Kontraktues vazhdon të insistojë në një specifikim që, sipas vlerësimit tonë profesional, nuk është teknikisht i realizueshëm në konfigurimin e kërkuar dhe nuk është i mbështetur në standardet e prodhuesve, krijohet përshtypja se kjo kërkesë mund të favorizojë një konfigurim ose një operator ekonomik të caktuar, gjë që bie ndesh me parimet e konkurrencës së lirë dhe trajtimit të barabartë të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Përgjigje ne Vendimin e AK-se, pika 4:

Nga përgjigjja e Autoritetit Kontraktues konstatohet se edhe vetë ai nuk ka sqaruar në mënyrë të qartë përmbajtjen e këtij specifikimi. Në një pjesë të përgjigjes i referohet sistemit të tërheqjes, ndërsa në pjesën tjetër mbajtësit të peshave, duke trajtuar dy elemente teknike me funksione të ndryshme. Për rrjedhojë, përgjigjja nuk sqaron kërkesën e parashtruar, por krijon paqartësi shtesë lidhur me atë se çfarë kërkohet realisht nga operatorët ekonomikë. Për më tepër, funksionet që Autoriteti Kontraktues i atribuohen mbajtësit të peshave dhe sistemit të tërheqjes realizohen tashmë nga konfigurimi me ngarkues frontal, i cili është kërkuar si pjesë e detyrueshme e specifikimeve teknike. Kjo tregon se kërkesa për mbajtës të peshave përpara nuk është e domosdoshme për realizimin e nevojave operative dhe nuk është në përputhje me konfigurimin teknik të traktorit të kërkuar

Konkluzion

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe gjatë trajtimit të kërkesës sonë për sqarime, nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Përgjigjet e dhëna ndaj kërkesës sonë për sqarime nuk kanë adresuar çështjet konkrete të ngritura nga ne, por në shumicën e rasteve kanë përmbajtur arsyetime dhe konkluzione, madje edhe kërkesa shtesë që nuk janë pjesë e dokumentacionit të tenderit. Kjo ka krijuar paqartësi të konsiderueshme lidhur me përmbajtjen e specifikimeve teknike dhe mënyrën e vlerësimit të ofertave, duke cenuar parimet e transparencës, sigurisë juridike dhe

trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Po ashtu, nga vetë përgjigjet e Autoritetit Kontraktues rezulton se një pjesë e specifikimeve teknike janë hartuar duke u bazuar në **"nevojat operative"**, e jo në standardet teknike të përcaktuara në nenin 28, paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik. Si rrjedhojë, disa nga kërkesat teknike rezultojnë të jenë të paqarta, të panevojshme, teknikisht të perealizueshme ose jo proporcionale me objektin e prokurimit, duke kufizuar pa arsye konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që bazuar në të gjitha argumentet dhe faktet e paraqitura më lart, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që:

1. Të aprovojë ankesën tonë si të bazuar dhe të konstatojë se pretendimet e ngritura nga ana jonë janë të qëndrueshme dhe të argumentuara.
2. Të urdhërojë pezullimin e aktivitetit të prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar lidhur me ligjshmërinë e kërkesave të përcaktuara në procedurën përkatëse.
3. Duke marrë parasysh faktin se vetë Autoriteti Kontraktues ka shfaqur paqartësi lidhur me specifikat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, si dhe nuk ka ofruar sqarime të plota dhe konkrete ndaj kërkesave tona për sqarim, të cilat janë pjesë e detyrimeve ligjore në kuadër të procedurës së prokurimit, kërkojmë që OSHP-ja të anulojë këtë thirrje për kontratë të inicuar nga Autoriteti Kontraktues.

Në rast se Autoriteti Kontraktues e konsideron të nevojshme vazhdimin e këtij aktiviteti të prokurimit, kërkojmë që ai të kryejë paraprakisht një analizë dhe hulumtim të duhur të tregut, si dhe të hartojë specifikimet teknike duke u bazuar në standarde të aplikueshme, kërkesa reale dhe parimin e proporcionalitetit, e jo përmes përcaktimeve të cilat kufizojnë konkurrencën ose reflektojnë vetëm nevoja operative të paargumentuara teknikisht.

Në këtë mënyrë do të sigurohej një procedurë transparente, konkurruese dhe në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

N.P.T. HAXHIJAH SH.P.K. konsideron se kjo menyre vleresuese e demton kompaninë tone e cila ka përvorje shumë vjeqare në furnizim e në këtë mënyrë na pamundëson ushtrimin e aktivitetit ekonomikë e në të cilat është investuar në staf të trajnuar. Dëmet tjeter materiale konsistojnë në koston e përgaditjes së tenderit.

10. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.